




REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRAN

Nr. / Br. 355 19 / 24

Nr. i fq. / Br. st. - 2 -

Data: / Datum: 23.07.2024

VUSHTRRI - VUÇITRAN



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E VUSHTRRIË

09.nr. 34 /2024
Date 23.07.2024

Bazuar në Rregulloren me numër protokollit **01/nr.56/24** datë **28.03.2024** Për Përkrahjen e Fermerëve në Bujqësi dhe Bizneseve në Sektorin Privat, Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural Shpallë:

THIRRJE PER APLIKIM

Për fermerët e Komunës së Vushtrrisë për përfitim në kuadër të implementimit të projektit: " Subvencionimi i prodhimtarisë së qumështit".

I. Qëllimi i thirrjes për aplikim

Qëllimi i thirrjes për aplikim është njoftimi i të gjithë fermerëve – blegtorëve prodhues të qumështit, të Komunës së Vushtrrisë se Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural në kuadër të Programit për Zhvillimin e Bujqësisë 2024 do të subvencionojë prodhimtarinë e qumështit për periudhën korrik-dhjetor 2023.

II. Mënyra e subvencionimit.

- Subvencionimi do të bëhet për litër të qumështit të dorëzuar në pikë grumbulluese ose në fabrika të përpunimit të qumështit në vlerë prej € 05€/litër;
- Përfitues do të jenë fermerët prodhues të qumështit sipas standardeve të legjislacionit në fuqi.

III. Kriteret e përcaktuara

- Aplikuesi duhet të jetë banorë i Komunës së Vushtrrisë.
- Të dorëzoj më shumë se 2000 litra qumësht për 6 muaj.

- Të posedoj kontratë, të vërtetuar nga noteri, për shitjen e qumështit në ndonjërin nga qumështoret e licencuara ose me ndonjërin nga pikat grumbulluese të qumështit të regjistruara si biznes dhe që kanë kontratë me ndonjë nga qumështoret e licencuara;
- Të ofroj dëshmi për sasinë mujore të qumështit të shitur (dorëzuar) në ndonjërin nga qumështoret e licencuara;
- Të ofroj dëshmi bankare për sasinë mujore të qumështit të shitur (dorëzuar).

IV. Dokumentacioni i nevojshëm:

1. Kopja e letërnjoftimit;
2. Konfirmimin nga banka për posedim të llogarisë bankare aktive;
3. Vërtetimin nga pika grumbulluese ose qumështorja për sasinë e qumështit të dorëzuar për periudhën Korrik- Dhjetor 2023;
4. Kopja e listës së verifikimit të kafshëve të lëshuar nga sektori për identifikim dhe regjistrin në kuadër të AUV;
5. Dëshmia e pagesës nga banka për sasinë e qumështit të shitur (dorëzuar)- pasqyra bankare;
6. Kopja e kontratës, e vërtetuar nga noteri, për furnizim me qumësht, të lëshuar nga qumështoret e licencuara ose pikat grumbulluese të regjistruara si biznese dhe të cilat kanë kontratë me ndonjë qumështore të licencuar.

Kjo thirrje publike është e hapur për aplikim prej datës: 24.07.2024 – 07.08.2024.

Aplikacioni dorëzohet në zyrën e pranimit (QSHQ) çdo ditë pune.


z. Ferit Idrizi



Kryetar i Komunës



z. Ergin Sunguri



Drejtor i DBZHR